



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
REKTORI

Nr. 2231 Prot.

Tiranë më 24/06/2021

URDHËR

PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET
DREJTUESE NË AKADEMINË E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 39, nenin 131; në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në Urdhërin Nr. 173, datë 22.06.2021 të MASR “Për procesin zgjedhor për autoritetet drejtuese në Akademinë e Studimeve Albanologjike”; në Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike”:

URDHËROJ

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet drejtuese në Akademinë e Studimeve Albanologjike.
2. Fushata zgjedhore fillon në datën **24.06.2021**.
3. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese në Akademinë e Studimeve Albanologjike është data **21.07.2021**.
4. Punonjësit e ASA janë të lutur të aplikojnë pranë Senatit, për anëtar të Komisionit Institucional Zgjedhor dhe për anëtar të Komisionit të Apelimit të ASA-së. Aplikimet pranohen deri në datën **27.06.2021** edhe **online** në adresën **info@asa.edu.al**.

REKTORI

Akademik prof.dr. ~~Marenglen Verli~~